



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

**Kryesues i Senatit**  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 705 Dt 22.03.2022

Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenin 166, paragrafin 4 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 dt. 30.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Rregullores nr. 1667, dt. 28.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, si dhe duke marrë parasysh rekomandimin e Komisionit të Ankesave të Senatit, në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2021, mori:

**VENDIM**

- I. Për rishpalljen e konkursit për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik të Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, për të gjitha pozitat nga konkursi i shpallur më 01.10.2021, i korrigjuar më 4.10.2021 dhe 14.10.2021, të cilat me vendimin nr. prot. 398, të dt. 16.02.2022, janë anuluar për shkak të shkeljeve të afateve të përcaktuara me Rregullore nr. 1667, dt. 28.09.2021.
- II. Rishpallja e konkursit nga pika I e këtij vendimi do të bëhet për këto pozita:

**II. 1. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike**

- a) Një mësimdhënës për lëndët: Grup lëndësh nga informatika inxhinierike.
- b) Një mësimdhënës për lëndët: Qarqe kompjuterike; Komponentet elektronike; Elektronika digjitale; Simulimet me kompjuter, Automatizimi i prodhimtarisë dhe robotika.
- c) Një mësimdhënës për lëndët: Teknologjia e përgjithshme e materialeve; Vizatim teknik me gjeometri deskriptive; Teknikat matëse; Vizatim me kompjuter, Softuer aplikativ.
- d) Një asistent për Grup lëndësh nga Ekonomia.

**II. 2. Fakulteti i Edukimit**

- a) Një mësimdhënës për lëndët: Shkenca shoqërore në arsimin fillor; Shkenca shoqërore në edukimin parashkollor; Edukatë qytetare; Shkolla dhe komuniteti.
- b) Një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e leximit letrar; Histori e letërsisë kombëtare; Letërsi për fëmijë.
- c) Një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e përgjithshme me praktikë; Praktika pedagogjike II me metodologji; Praktika pedagogjike me metodologji III; Teoria e mësimit; Shkathtësitë e mësimit akademik.

Rr. (St.)Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

- d) Një asistent për lëndët: Hyrje në psikologji; Puna me fëmijë të talentuar; Psikologji edukimi; Psikologji e personalitetit; Psikologji zhvillimore.
- e) Një asistent për lëndët: Shkencat natyrore në arsimin fillor I; Bazat e shkencave natyrore në edukimin parashkollor II; Bazat e shkencave natyrore në arsimin parashkollor I; Shkencat natyrore ë arsimin fillor II; Eksperimenti në fëmijërinë e hershme; Edukim mjedisor.
- f) Një asistent për lëndët: Filozofi e edukimit; Metodologji e përgjithshme me praktikë I; Praktika pedagogjike II me metodologji; Menaxhimi i klasës; Tendencat bashkëkohore në arsim; Vlerësim në arsim; Bazat e hulumtimit në edukim; Bazat e hulumtimit në arsim.
- g) Një asistent për lëndët: Praktikë Pedagogjike me Metodologji III; Zhvillim i Kurrikulave; Praktika pedagogjike; Teori e mësimit; Zhvillim i kurrikulave; Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe portfoliot.
- h) Një asistent për lëndët: Histori kombëtare, Historia e arsimit kombëtar, Edukatë qytetare.


III. Rishpallja e Konkursit për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik, për pozitat nga pika II e këtij vendimi, do të hartohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 dt. 30.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe Rregullores nr. 1667, dt. 29.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM.

IV. Konkursi do të publikohet në web-faqen zyrtare të Universitetit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

- 1. Arkivit të UMIB-it;
- 2. Menaxhmentit;
- 3. Fakulteteve;
- 4. Zyrës së personelit

  
Prof. dr. Alush Musaj  
Kryesues i Senatit